

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE**  
**DHE PRIVATIZIMIT**  
Drejtoria e Privatizimit te Sektoreve Strategjike

**U R D H E R**

Nr. 189/4 Date 5.7. 1999

**PER**  
**“ZVOGELIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE**  
**SH.A. ALBKROM TIRANE”**

Me cilesine e aksionerit tevetem te shoqerise “Albkrom” Sh.a bazuar ne nenin 2, te Ligjit nr. 8237, date 1.09.1997 “Per disa ndryshime ne Ligjin nr. 7926, date 20.4.1995 “Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare” (ndryshuar me akte te tjera ligjore) si dhe ne baze te nenit 164, te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”,

**U R D H E R O J:**

1- Te zvogelohet kapitali themeltari shoqerise “Albkrom” Sh.a. nga 5.553.257.000 lek ne 4.498.020.419 lek, nepermjet zvogelimit te numerit te aksioneve qe perbejne kapitalin e shoqerise, nga 5.553.257 ne 4.498.020 aksione.

2- Te behen ndryshimet si me poshte ne piken 4 te Aktit te Themelimit dhe ne nenin 3 te Statutit:


“Kapitali themeltar i shoqerise eshte 4.498.020.419 lek.

Numeri i aksioneve eshte 4.498.020.”

3- Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Sektoreve Strategjike dhe Drejtoria e Shoqerise te bejne veprimet perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33, te Ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 “Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare”.

**MINISTRI**

**YLLI BUFI**



**RAPORT I EKSPERTEVE KONTABEL  
TE AUTORIZUAR MBI MODALITETET  
E NDARJES SE KATER NJESIVE  
PRODHUESE TE Sh.a "ALBKROMI"**

**Keshillit Mbikqyres te Sh a "ALBKROMI" Tirane**

**Zoterini,**

Ne Ekspertet Kontabel te Autorizuar, Kole GJONI dhe Esmeralda BALLUKU, te caktuar me shkresen nr 155 date 22.04.1999, te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit Z. Ylli Bufi, lidhur me rishikimin e kapitalit te Korporates si dhe per shkeputjen e kater njesive te prodhimit te kesaj Shoqerie japim, Raportin tone mbi modalitetet e ndarjes sa me poshte vijon:

Sh a "ALBKROMI" eshte rregjistruar si shoqeri anonime me Vendimin e Gjykates nr 14014 date 29.02.1996 me kapital te nenshkruar 5.553.257.000 leke. Kjo Shoqeri, selia e se ciles ndodhet ne Tirane me adrese blloku "Vasil Shanto", perbehet nga Drejtoria e Pergjithshme si dhe 13 njesi prodhuese. Shoqeria ALBKROMI sh.a. zbaton dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi, si Ligji 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare", Ligji 7661 date 19.01.1993, "Per kontabilitetin" si dhe cdo ligj dhe akt nenligjor i detyrueshem per tu zbatuar.

Llogarite vjetore te Shoqerise hartohen per periudhen ushtrimore Janar - Dhjetor te cdo viti, mbi bazen e Bilanceve Kontabel te njesive prodhuese. Bilanci i konsoliduar pasqyron gjendjen e llogarive dhe ate financiare, si dhe rezultatin per ushtrimin e mbyllur.

Me vendim te Keshillit Mbikqyres Nr 23, dt.04.11.1998, si dhe te Urdherit nr 155 date 22.04.1999, eshte vendosur te shkepuse nga Sh a "ALBKROMI" njesite e meposhteme:

1. Miniera e Kromit Bater
2. Miniera e Kromit Ternove
3. Miniera e Kromit Klos
4. Miniera e Kromit Kam - Tropoje.



Gjendja e llogarive te Sh.a. dhe te njesive prodhuese ne momentin e shkeputjes bazohet ne bilancin e dt 31.12.1997. Te dhenat e ketyre bilanceve paraqiten ne shenimet financiare bashkangjitur ketij raporti.

Ne perputhje me Ligjin Nr 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" Sh.a.Albkromi ka paraqitur modalitetet e zvogelimit te kapitalit nepermjet te cilat jane verifikuar nga ana jone dhe mbi kete baze eshte hartuar ky raport.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone rezulton se se ndarja e kapitalit behet:

**Arsyeja :**

Zvogelimi i Kapitalit pasoje e shkeputjes te kater njesive te prodhimit te mesiperm arsyetohet me faktin se ne keto njesi nuk mund te vazhdoje proces i prodhimit dhe i shitjes, dhe per rrjedhim keto njesi do te vihen ne konservim.

**Kushtet e zvogelimit:**

Baze per llogaritjen e pjeses se kapitalit qe zvoglohet nga ndarja eshte:

- Bilanci i korporates dt. 31.12.1997 si dhe bilancet e njesive ekonomike dt.31.12.1997.
- Inventarizimet e kryera nga komisionet e inventarizimit te Sh.a ne njesite e mesiperme.
- Te dhenat e ekspertizes kontabile te kryera me rastin e kontrollit te llogarive te vitit 1997.
- Raporte dhe informacione te Drejtorise se Sh.a dhe Drejtorive te njesive qe ndahen.

**Modalitetet e ndarjes:**

Veprimet e ndarjes do te kryehn sipas ketyre modeliteteve:

1. Shoqeria. do te ruaje formen dhe emrin qe ka tani "Sh.A."Albkromi"
2. Aktivitet, pasivitet dhe kapitali qe ndahet do te mbeten si aktive ne ruajtje prane Shoqerise, te ciles i ruhen forma, selia dhe statusi i saj.
3. Kalimi i aktiveve, pasiveve dhe i kapitalit eshte llogaritur sipas Bilanceve te Riformuar me date 31.12.1997 te cilat i bashkangjiten ketij Raporti.
4. Sh.a Albkromi do te beje korigjimin e statutit, aktit te themelimit dhe vendimin perkates te gjykates duke reflektuar ndryshimet qe shkaktohen nga zvogelimi i kapitalit pasoje e shkeputjes.
5. Detyrimet debitore dhe kreditore te pasqyruara ne bilancet e njesive do te mbeten ne bilancin e Sh.a ALBKROMI.






6. Ne perfundim te ketyre veprimeve bilanci e Sh.a Albkromi do te paraqitet i reformuar sipas modelit bashkangjitur, kurse bilancet e njesive qe shkeputen do te paraqiten te permbledhura dhe vec e vec.

Shuma e kapitalit qe i mbetet Sh a "Albkromi"-t Tirane eshte e barabarte me 4.498.020.419 leke, ( katermiliard e katerqint e katerqint e nentdhjete e tete milion e njezete mije e katerqint e nenetmbedhjete )leke.

Bashkangjitur ketij Raporti, ju paraqesim Gjendjet Financiare me date 30.12.1997, te Korporates, te njesive qe shkeputen, si dhe gjendja e ndryshuar si pasoje e ndarjes se Shoqerise.

Tirane me 11 maj 1999

Ekspertet Kontabel te AutORIZUAR

  
**Kole GJONI**  
  
  
**Esmeralda BALLUKU**  
  




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT

Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve te Vogla dhe te Mesme

Blvd. Dëshmorët e Kombit Nr.2  
E-mail: postmaster@mepp.tirana.al  
Internet: HTTP://WWW.MEPP.GOV.AL

Tel. +355 42 259 52  
Tel/Fax +355 42 251 54

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tirane, me 01.2000.

U R D H E R  
Nr. 188 Date. 1.6 . 2000.

PER  
ZVOGELIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE "ALBKROMI" SH.A  
TIRANE

Ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8099 date 28.03.1996 , Dekretin Nr 1631 date 1.11.1996, Ligjin nr 8158, date 7.11.1996 dhe nenit 164 te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem

U r d h e r o j :

1-Te zvogelohet kapitali themeltar i "Albkromit" sh.a Tirane nga 4.498.020.419 leke ne 3.405.413.244 leke nepermjet zvogelimit te numrit te aksioneve qe perbejne kapitalin e shoqerise, nga 4.498.020 ne 3.405.413 aksione :

2-Te behen ndryshimet si meposhte ne piken 4 te Aktit te Themelimit dhe ne nenin 3 te statutit:  
Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 3.405.413.244 leke.  
Numri I aksioneve eshte 3.405.413

3-Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla dhe te Mesme dhe Drejtoria e Shoqerise te bejne veprimet perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare.



**RAPORT I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR  
MBI MODALITETET E ZMADHIMIT DHE ZVOGELIMIT  
TE KAPITALIT TE SH.A. "ALBKROMI" -TIRANE**

**Zoti Minister,**

Ne Ekspertet Kontabel te Autorizuar, Kole GJONI dhe Esmeralda BALLUKU, Eksperte kontabel te Autorizuar te Shoqerise, te caktuar me Urdherin Nr.66, dt.14.02.2000 te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit z. Mustafa Muci, lidhur me ndryshimin kapitalit themeltar te Sh.a. "Albkromi" japim raportin tone sa me poshte vijon:

Shoqeria "ALBKROMI" sh a eshte e rregjistruar si shoqeri anonime me Vendim te Gjykates te Rrethit Tirane Nr 14014 dt. 29.02.1996 me kapital thmeltar 5.553.257.000 leke.

Me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr 14014/1 dt. 22.09.1999 kapitali themeltar i Sh.a."Albkromi" eshte 4.498.020.419 leke.

Kjo shoqeri, selia e se ciles ndodhet ne Tirane me adrese: Blloku "Vasil Shanto", perbet nga Drejtoria e Pergjithshme dhe 9 njesi prodhuese. Sh.a."Albkromi" zbaton dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi, si Ligji Nr 7638, dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", Ligji Nr 7661, dt.19.01.1993 "Per kontabilitetin" si dhe cdo ligj dha akt nenligjor i detyrueshem per tu zbatuar.

Llogarite vjetore te shoqerise hartohen per periudhen ushtrimore Janar – Dhjetor te cdo viti ushtrimor, mbi bazen e bilanceve kontabile te Njesive prodhuese vartese. Bilanci i Shoqerise pasqyron gjendjen e llogarive dhe rezultatin financiar per ushtrimin e mbyllur.

Ne zbatim te Ligjeve 7973 date 26.07.1995 "Per koncesionet dhe pjesemarrjen ne sektorin privat ne sherbimet publike dhe infrastrukture" dhe Ligjin 8590 date 23.03.2000 "Per miratimin e marreveshjes te koncesionit te formes BOT..." si dhe me vendim te Keshillit te Ministrave Nr.508, dt.08.11.1999, eshte vendosur qe te zvoglohet kapitali thmeltar i Sh. a. Albkromi, pasi njesite te meposhteme do te shkeputen nga Sh.a.Albkromi dhe do ti jepen ne administrim OSHA, si dhe do te kalojne ne zvogelim per kalim ne konservim.

**Per OSHA**

- 1.Miniera e Kromit Katjel – Prrenjas
2. Miniera e Kromit Pojske - Pogradec
- 3.Uzina e Ferrokromit Elbasan

**Ne konservim**

4. Objekti minerar Qaf – Lame qe administrohet nga Miniera e Kromit Bulqize.
5. Miniera e Kromit Kalimash

**Shtohet** Toka me vleren e saj per 195.256.922 leke per te gjitha njesite vartese te Shoqerise

**Pakesohet** Toka per 4 Minierat qe kane kaluar ne konservim per te cilat jane bere veprimet ligjore perkatese ne Vendimin e Gjykates 14014/1 date 22.09.1999.

Gjendja e llogarive te Sh.a dhe te njesive prodhuese ne varesi te saj bazohet ne bilancin e dates 31.12.1999.

Ne perputhje me Ligjin Nr.7973, dt.26.07.1995 "Per koncesionet dhe pjesemarrjen e sektorit privat ne sherbimet publike dhe infrastrukture", me Ligjin Nr.8590, dt.23.03.2000 "Per miratimin e "Marreveshjes se koncesionit te formes "BOT" per Uzinen e Ferrokromit Elbasan dhe per Minierat e Kromit te Prrenjasit e Pojskes, ndermjet Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit dhe Shoqerise Italiane DARFO Spa dhe dhenien e disa stimujve dhe garancive per koncensionarin e kesaj marreveshje", Ligjit Nr 7638, dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", Ekspertet Kontabel te sh a Albkromit kane paraqitur modalitet e

zvoglimes te kapitalit nepermjet te cilit jane verifikuar nga ana jone shumet per zvogelim dhe mbi kete baze eshte hartuar ky raport.

Nga verifikimet e kryera nga ana jone rezulton se zvoglimes i kapitalit behet per 1.287.864.197 leke dhe zmadhimes i kapitalit behet per 195.256.922 leke (shih pasqyren bashkangjitur 1 dhe 2)

**Arsyeja:**

Zvoglimes i kapitalit behet sepse tre njesite e mesiperme si dhe Miniera e Kromit Kalimash, Objekti minerar "Qaf - Lame" ne vartesi te Minereres Bulqize, duke patur probleme teknologjike dhe pamundesi per investime, keshtu qe UFK Elbasan, Minierat Prrenjash dhe Pojske i kalojne ne administrim OSHA .

Zmadhimes i kapitalit per perfshirje te tokes ne kapital behet pasi me transformimin e Minerave ne Shoqeri Tregtare nuk ishte bere ky kalkulim dhe llogaritje.

Zvogelimes i kapitalit per vleren e tokes per 4 njesite e kaluara ne konservim sipas Vendimit te Gjykates 14014/1 date 22.09.1999

**Kushtet e zmadhimit dhe zvogelimit:**

Per ndryshimin e kapitalit themeltar te Sh.a. merren parasysh:

- Bilanci i Sh.a. dt.31.12.1999 si dhe bilancet e njesive ekonomike qe i jepen OSHA,
- Inventarizimet e kryer per llogari te vitit 1999.
- Verifikime te kryera mbi bilancet dhe deklarimet financiare te Sh.a.
- Raporte dhe informacione te Drejtorise se Sh.a. dhe te njesive ekonomike.
- Aktet e vleresimit te tokes sipas vleresimeve te bera nga Urbanistikat e rretheve perkatese

**Modalitete e zmadhimit dhe zvogelimit:**

Veprimet e zmadhimit dhe zvogelimit do te kryhen sipas ketyre modaliteteve:

1. Shoqeria do te ruaje formen dhe emerine qe ka tani Sh.a."Albkromi" Tirane.
2. Kapitali i Sh.a.Albkromi do te ndryshohet per vleren e kapitalit te njesive te cituara me lart.
3. Aktivet e qendrueshme dhe aktivet qarkulluese te njesive prodhuese qe kalojne OSHA dhe ne konservim.
4. Detyrimet e njesive qe kalojne OSHA dhe ne konservim do te mbeten ne bilancin e Sh.a.
5. Sh. a. Albkromi do te beje korigjimin e statutit, aktit te themelimit si dhe do te kerkoje te behet edhe ndryshimi perkates ne Vendimin e Gjykates te rrethit Tirane.
6. Ne perfundim te ketyre veprimeve bilanci i Sh.a. do te paraqitet i Reformuar sipas modelit bashkangjitur.

**Kapitali themeltar i Sh.a.**

Shuma e kapitalit te nenshkruar te Shoqerise "ALBKROMI" sh. a. pas zmadhimit dhe zvogelimit te kapitalit eshte 3.405.413.244 leke.

Bashkangjitur ketij raporti eshte :

- Bilanci i reformuar i Shoqerise ne date 31.12.1999.
- Tabelat e zmadhim dhe zvogelim te Kapitalit lidhur me zmadhimin dhe zvogelimin e tij.

Tirane, me 12.05.2000

**EKSPERT KONTABEL TE AUTORIZUAR**

**Kole GJONI**



**Esmeralda BALLUKU**

